**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

**KOMUNA E DEÇANIT**
MUNICIPALITY OF DECANI - OPSTINA DECANI

Raport pune Janar-Qërshor 2019



# RAPORT I PUNËS JANAR – QËRSHOR 2019
# I KRYETARIT TË KOMUNËS Z.BASHKIM RAMOSAJ

**Deçan – Korrik / 2019**

Raport pune Janar-Qërshor 2019

Në periudhën raportuese Janar-Qërshor 2019 të zyra e kryetarit janë regjistruar 859 lënde prej tyre në proces janë 716 janë miratuar 133 ,prej tyre 2 janë refuzuar ,5 janë pezulluar , 3 janë anuluar .
Sa i përket kërkesave për qasje në dokumenta zyrtare Janar-Qërshor 2019, nga zyrtari përgjegjes është raportuar se janë parashtru 16 kërkesa nga organizatat jo qeveritare dhe mediat të cilat kanë marë edhe përgjigjjet e duhura në afat kohorë të paraparë më ligj.

**Nënkryetari i Komunës** -ka mbajtë takim të vazhdueshmë më qytetarë të komuën së Deçanit ku në bazë të këtyre takimeve ka marë edhe kërkesat të cilat i ka adresu tek organet përgjegjëse.Po ashtu ka ndihmuar edhe Kryetarin në punët e përditshme.

**Zyra për informim** –Gjatë kësja perjudhe kohore zyra për Informim në Komunën e Deçanit ka përcjell në vazhdimësi aktivitet ditore , javore dhe mujore ku janë publikur edhe në portalin zyrtar të komuës https://kk.rks-gov.net/decan/ në ueb faqen e Komunës,në Yutube dhe në Facebook, ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtuara dhe të gjitha vendimet , rregulloret, projektet , vendimet ,konkurset , njoftimet e zyrës se prokurimit ,njoftimet për anulim njoftimet për dhënie të kontratave, njoftim për shfuqizim të kontratave , dhe shkresa tjera në interes për qytetarët e komunë së Deçanit.Gjatë kësja perjudhe kohorë ësht miratuar edhe ,,Plani i veprimit për Transparecë 2019-2023’’. Ka mbajtur kotakte te rregullta me mediat ku ka përcjellë edhe njoftimet , komunikatat në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në komuën e Deçanit duke i mbajtur mediat e informuara në vazhdimësi për ngjarjet në komunën e Deçanit.. Në vazhdimësi ka përcjllë agjendën e kryetarit si në nivel lokal po ashtu edhe në nivel qëndroë , dhe një ser aktivitetesh tjera të cilat i takojnë kësaj zyre.

Zyra e Auditorit të Brendshëm –

Zyra e Personelit –
Zyra komunale për komunitete dhe Kthim –
Zyra për Integrime Evropiane

## 1. Drejtoria e Administratës Komunale

**Gjatë përjudhës Janar-Qërshor 2019**

Në Administratën Komunale në Deçan në përjudhen kohore Janar –Qërshor tek zyra pritës janë pranuar 21837 kerkesa te Egzegutivit, Legjeslativit dhe Drejtorateve Komunale.
1. Zyra pritëse ka përpunuar 16157 landë, ne proces ka 23 landë.
2. Zyra Ligjore ka kryer gjithsejtë 500 landë të nryeshme.
3.Zyrat e Gjendjeve civile ne total kanë kryer13002 regjistrime ne sistemin e gjendjes civile.
4.Nga këto regjitrime 833 kanë kaluar ne regjistër qendror.

Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 21350 Çertifikata të llojeve te ndryeshme.
Ne këte periudhe edhe ne sektorët tjera janë kryer punët në kontinuitet si ne sektorin e furnizimit, sektorin e mirëmbajtëjes , zyrës për teknologji informative , zyrës për përkthime etj. Kjo eshtë statistika ne vija te pergjithëshme , ndërsa te bashkangjitur keni edhe tabelaret secilit zyrtar veç e veç .

Mungon tabela

## 2. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

**Gjatë përjudhës Janar-Qërshor 2019**

Pjesëmarrja në takime informuese për Cross-Border Programme Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 IPA (II), dhe në bashkëpunim me Komunen e Andrijevices në Malin e ZI dhe Shoqatën Bjeshkatare Alpiniste "Shkelzen Haradinaj", në Deçan kemi përgatitur projektin narratv dhe financiar dhe kemi aplikuar me projektin me titull: **Tourism hubs for better tourism offer in less advantaged mountainous areas ( Qendra Turizmit për oferta me të mira turistike në zonat me pak të favorizuar malore), në vlerë 190337.9585 Euro.**
**Janar – Maj,** Informimi i qytetarëve dhe bizneseve për thirrjet për aplikim për grante në Ministrin e Zhvillimit Rajonal dhe ndihme rreth aplikimeve për grante 2019, **nga keto skema**

**Loti I, II dhe III, kanë përfituar: Tre (3) persona Loti I, dhe Shtatë ( 7 ) persona Loti III ndërsa në Lotin II nuk ka të përfituar.**
**Janar – Shkurt,** pergatitja e dy projekteve narrative- aplikacionit, dhe **aplikimi në Ministrin e Zhvillimit Rajonal me Projektin me titull** : **"Zhvillimi i turizmit në Bjeshkët e Deçanit", përkatësisht ndertimi i sistemit të elektrifikimit - vendosjen e shtyllav elektrike dhe përçueseve të rrymes nga qendra e Deçanit deri në Bjeshkën e Madhe dhe të Deçanit, shtrirje e rrjetit elektrik që përfshin deri në 30 km gjatësi, në skemen granteve " Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar", nga kjo skemë Komuna e ka përfituar ketë projekt në vlerë: 200.000 €.**

**Janar – Maj**, pjesëmarrje në takime me Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal për thirrjen për projekt në kuader të Bashkëpunimit Ndërkomunal, dhe përgatitja e Projektit Narrative dhe bashkëpunim me Komunën e Pejës aplikimi me Projekt me titull: Projekti "Ndërtimi i Urës mbi Lumin Lumbardh që lidhë fshatin Vranoc i Vogël nga Komuna e Deçanit me fshatin Vranoc i Madh nga Komuna e Pejës dhe trasimi i rrugës që lidhë fshtarat Vranoc i Vogël me fshatin Lumbardh në zonën kadastrale të Komunës së Deçanit", në vlerë 297,920.08 €.

**Janar – Qershor,** bashkëpunimi me organizaten jo-qeveritare Syri i Vizionit në Pejë, dhe në kuader të projektit të tyre për mbështetje të bashkësive lokale kemi përfituar vlerë financiare 900 €, ndërsa buxheti tjeter nga komuna kemi rregulluar drenazhin rreth mureve të Qendres Informuese Turistike dhe kemi shtruar në trotuar hyrjen e kësaj qendre. Në muajin Qershor kemi hapur Qendrën Informuese Turistike dhe tani aty punojnë tre zyrare me kontrate me kohe të caktuar gjashtë mujore, poashtu kemi kryer rregullimin e nyjeve sanitare dhe vendosjen e pajisjeve tjera.

**Janar – Qershor,** në kuader të bashkëpunimit me KADC në projektin e tyre ndërkufitar për përmiresimin e ofertës turistike me ekspertë të turizmit kemi vizituar pika turistike në zonat rurale, pastaj kultivuesit e mjaltës, prodhuesit e produketeve të qumeshtit, të rakis, gratë që punojnë punime artizanale dhe veshje kombëtare dhe kemi vizituar Bjeshkën e Belegut, të cilat kanë përgatitur plane – punë apo hapat që duhet ndërmerr komuna jonë për promovim të turizmit siq janë: Kulla Hoping, Festivalin Veror të Artizanaleve, Alpinizem të Planifikuar. Poashtu përfaqësuas të KADC se bashku me Guid Operator nga Shqipëria dhe SËISSCONTACT kanë

vizituar kullat dhe mullinjet në Isniq dhe Drenoc. Zyrtari për Turizem Mirsat Nimonaj dhe eksperti i flores dhe i faunes Sadri Lokaj kanë marrë pjesë në trajnimin “Ndjekja e shtigjeve për banoret e maleve- shpezëve”, në Plav me datë 26-28 Qershor 2019.

**Janar – Qershor,** në kuader të Marrëveshjes së Bashkëpunimit më CDF, Drejtoresha Fitore Hulaj ka marrë pjesë në punëtorin Manaxhimi i Destinacionit Turistik, 12-13 Shkurt në Pejë. Ndërsa anetarë të Shoqatës Bjeshkatare Apliniste “Shkelzen Haradinaj”, kanë marre pjesë në Udhetimin Familjarizues në Kosovë ku janë vizituar pikat turistike Pejë, Deçan dhe Junik.
**Maj** - Në kauder të Bashkëpunimit me Institutin e Politikave Publike dhe Private (Shqipëri) në projektin e tyre ndërkufitar me Shqipërin dhe Kosovën, zyrtare nga drejtoria kanë marre pjesë në Sesionin Rajonal për Turin Kulturor të Bjeshkëve të Nemuna.
**Janar- Qershor**- kemi vazhduar bashkëpunimin me Agjencis për Zhvillim Rajonal, ku kemi derguar informata për Komunën e Deçanit për përgatitjen e Profilit Rajonal të Kosovës nga ana e MZHR-es, pastaj adresuar të kjo agjenci biznese dhe persona tjerë për ndihme për shkrimin e projekteve dhe aplikim për grante, kemi marre pjesë në takim me Bordin në Janar, në Mars në takimin me temë: Identifikimi i potencialeve investuese, prioriteteve dhe projeketeve Strategjike Rajonale për Zonën Ekonomike- Perëndim. Takim në muajin Maj në Klinë me bizneset Lokale dhe Drejtorive për Zhvillim Ekonomik me temë: Shqyrtimi i masave mbështetëse për zhvillimin e bizneseve dhe brendeve të Rajonit Perëndim. Kemi derguar informata për brendet kryesore në Komunën e Deçanit.
**Janar – Qershor,** kemi vazhduar bashkëpunimin me Ministrin e Tregtis dhe Industris të Republikës së Kosovës, në kuader të takimeve për Ligjin e Turizmit, fuqizmin e turizmit në Kosovë, poashtu kemi informuar qytetarët për thirrjen e MTI-s për mbështetje me grante të Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
**Maj**- Me ftesë të Agjencisë për Punësim dhe Ministris për Punë dhe Mirqenie Sociale, Drejtoresha Fitore Hulaj ka marrë pjesë në Trajnimin për: Menaxhimin Strategjike dhe të Projektit.

**Prill – Korrik,** përmes Zyren se Kryetarit, kemi krijuar bashkëpunim me Institutin për Politika Zhvillimore – INDEP, në bazë cilit bashkëpunim kemi plotesuar nje pyetësore të derguar ana tyre rreth Objektivav të Zhvillimit të Qendrushem sipas Agjendes 2030 të Kombeve të Bashkuar.

Në bazë ketij bashkëpunimi Drejtoresha Fitore Hulaj, Zyrtarja nga Kuvendi Komunal Vjollca Tetaj dhe nga Zyra e Arkivit Muje Sejfijaj kanë marre pjesë ne trajnimin tri ditore 23-25 Maj 2019, me temë: Plani për Integrimin e QZHQ-ve në Nivel Lokal. Ne Qershor INDEP ka mbajt punëtori me zyrtarë nga secila drejtori ku ka shfaqur Planin dhe Rekomandimet e QZHQ-ve për Komunën e Deçanit dhe përfshirjen e tyre në Planin Zhvillimor Komunal. Me 1 Korrik, Kryetari Bashkim Ramosaj ka nënshkruar Deklaratën që shpreh përkushtimin për zbatimin 17 –të Objektivav për Zhvillim të Qendrushëm të Kombeve të Bashkuar të njohura si Agjenda 2030.
**Shkurt dhe Maj-** kemi marrë pjesë në takime të Kolegjiumit për Zhvillimin Ekonomik Lokal, me temë në fushat e zhvillimit ekonomik lokal.
**Janar Qershor,** kemi pasur bashkëpunim me Fondacionin për Kosovar për Trashegimin Kulturor pa Kufij CHëB, se bashku me zyren për Informim kemi derguar informatat për aktivitet dhe festivalet vjetore që realizohen në Komunën e Deçanit. Zyrtarë nga Drejtoria kanë marre pjesë në Konferencën e 1-rë për ndikimin e kulturës në ekonominë e Rajonit të Dukagjinit, me 24 Qershor 2019.
**Prill- Korrik-** Kemi dhenë sugjerimet dhe propozimet për Rregulloren për Caktimin e Orarit të Punës në Lokalet Afariste në Komunën e Deçanit e inicuar nga Zyra e Kryetarit.
Qershor- me organizim të tour operatoreve privat, 13 Studenta nga Universiteti i Miamit në SHBA se bashku me Drejtoreshen e tyre Cathleeen Lynch kemi vizituar mullirin e Hasanramaj në Strellc, Kompleksin e Kullav në Drenoc dhe Kompleksin Memorial të Deshor137ve në Gllogjan.
**Janar – Qershor,** kemi pasur takime të veçanta më përfaqësues të bizneseve lokale të Deçan.
**Janar – Qershor,** kemi marre pjesë në takime të ndryshme të Kryetarit poashtu edhe në takimin e fundit në Korrik me banoret e Fshatit Dubovik rreth kërkesave dhe projekteve për ketë fshatë.
**Janar – Korrik,** kemi krijuar bashkëpunim të mirë me mediat në Kosovë dhe jemi ka mundohem që krijojm emisione të ndryshme për ti promovuar vlerat natyrore, kulturore dhe turistike të Komunës së Deçanit. **Janar – Qershor,** zyra për biznese në kuader të Drejtoris për Ekonomi dhe zhvillim ka kryer këto shërbime: **janë pajisur me numer unifikues afërsisht 890 – të biznese, janë regjistruar 83 biznese të reja, dhe janë kryer ndryshime gjithësejë 602 biznese.**

***3.Drejtoria Komunale e Arsimit –DKA***
***Gjatë përjudhës Janar-Qërshor 2019***

**Organizimi i Procesit Mësimor në SHFMU dhe SHML në Komunën tonë është organizuar dhe menaxhuar si vijon:**

- 5 takime pune me Këshillin e Drejtorëve te Shkollave te komunës (tema diskutimi: Organizimi i Procesit mësimor në shkollat tona).
-3 Takime pune me Koordinatorët e cilësisë në shkollat tona (tema diskutimi: Procesi mësimor në shkollat tona, ngritja e cilësisë, zbatimi i KB dhe Garat e ndryshme me nxënës).
-5 takime pune me Komisionin Komunal për organizimin e Garave në nivel komunal.
-DKA ka kryer Obligimet per mbarvajtjen dhe përgatitjen e Buxhetit për Arsim në nivel komune, duke përfshirë: Administratën e Arsimit, Arsimin Fillor (18 shkolla fillore), Arsimin e Mesëm (2 shkolla), si dhe të gjitha detajet përcjellëse rreth ndarjes, sistemimit dhe shpenzimeve të bugjetit në shkolla (në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave).
-1 Takim pune me Këshillin e Prindërve në nivel komunal,
- Takime te shumta pune: me Ministrin, Zyrtarët e lartë të MASHT-it, SIA-Pejë, kontakte dhe bashkëpunim me Zyrtarë, Institucione shtetërore dhe OJQ e ndryshme.
-20 hospitime monitorim i procesit mësimor në shkollat e komunës së Deçanit.
-3 Teste (Organizimi i Testeve obliguese nga MASHT: T. për Shkallë, T. i Arritshmërisë, MSH-2019.
-1 Test -Gara të diturisë në nivel komunal dhe shkollash (fituesit në N. Republikan), "Programi Nacional për Rininë", të gjithë nxënësit e komunës, niveli komunal 553 nxënës pjesëmarrës.
-5 lloje gara në nivel shkollash.
-10 gara në nivel komunal, Përkujdesje dhe organizim i Garave të diturisë dhe garave kulturo-sportive në nivel shkollash dhe në nivel komunal afërsisht 600 nxënës.
-Përkujdesje dhe organizim i trajnimeve të mësimdhënësve krahas kërkesave të kohës.
-DKA në bashkëpunim me MASHT, SBASHK, kemi organizuar trajnime për mësimdhënësit , ku janë trajnuar në fusha specifike lëmi arsimore rreth 347 mësimdhënës nga komuna jonë.
-Raport për çështje administrative dhe juridike gjatë gjashtë muajve janë përpiluar:
-28 vendime dhe njoftime për punëtorët e arsimit,
-19 vërtetime,
-9 pëlqime,
-6 konkurse në shkollat e komunës për vende te lira pune.
-Nxënës të komunës sonë, përveq garave i kemi pasur edhe në trajnime të ndryshme:
-SHFMU "L. Prizrenit" Deçan FSK "Improvizim i Termetit"
-Kampi Rinor –FSK, 5 nxënës pjesëmmarrës
-Përkujdesje dhe angazhim rreth procedurave për ndërtimin e shkollave të reja, renovimin e objekteve shkollore, furnizimin me paisje mjete mësimore (kabinete, paisje teknologjisë-TIK, paisje të sallave të edukatës fizike).
Në komunën e Deçanit këtë periudhe janë kryer procedurat për rregullimin dhe përmirësimin e Infrastrukturës shkollore nga MASHT dhe komuna:
-4 shkolla të reja, janë në përfundim procedurat e tenderimit (MASHT): SHFMU "L.Selimi", SHFMU "E. Mekuli", SHFMU "H. e Dukagjinit", SHFMU "L. e Prizrenit"

-2 shkolla vazhdon ndërtimi: SHFMU “Drita” në Gramaqel dhe SHFMU “V. e Llukës” në Llukë te epërme.
-1 objekt shkollor renovim SHFMU “J. Gërvalla” Prapaqan. procedurat e tenderimit (MASHT).
-2 objekte shkolla program Efiqence: SHFMU “D. e Vokshit” dhe SHFMU ”S. Vokshi”
-1 Furnizim me paisje sportive, Salla e Edukatës fizike GJ. “V. Frashëri”
-1 aneks, Ndërtimi i një aneksi (depo e druve) SHFMU “I. Boletini” procedurat e tenderimit (MASHT).
-Projekti i huamarrjes në 7 shkolla, furnizim me: kabinete, mjete mësimore dhe trajnime të ndryshme për mësimdhënës: SHFMU ”Maxhun Çekaj”,”Drita”,”Isa Boletini”,”Lan Selimi”,”Sylejman Vokshi”,”Deshmorët e Vokshit”dhe “Deshmorët e Baballoqit”.
-Përgatitja dhe përfundimi i procedurave administrative rreth pagesës të 3 pagave shtesë (sipas K.K) për 9 mësimdhënësit e pensionuar gjatë periudhës së parë të vitit 2019.

## ***4. Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike***

***Gjatë përjudhës Janar-Qërshor 2019***

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2019 Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim ka hartuar dhe azhuruar këto plane:

1. **Hartimi i Planit të vjetor të punës për vitin 2019.**
2. **Analiza dhe raporti i punës për vitin 2019, përgatitja e përformancës komunale për vitin 2019.**
3. **Hartimi i raporteve mujore të punës.**
4. **“Pikat më vërshuese nga të reshurat atmosferike në territorin e Komunës së Deçanit”**
5. **“Vlerësimi i rreziqeve nga shembjet dhe erozioni në Komunën e Deçanit”**
6. **“Vlerësimi i rrezikshmërisë së rrjetit elektrik në K. Deçanit”**
7. **“Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit”**
8. **Punë dhe detyra të veçanta sipas kërkesës.**
9. Planet e mbrojtjes për shkollat fillore dhe të mesme (pjesërisht) si dhe Plani i Mbrojtjes për Kuvendin Komunal dhe QKMF-së.

**Dalje në teren, rekomandime, njoftime**

Gjatë gjashtë mujorit të parë vitit 2019 sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim ju ka përgjigjur kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve duke dal në teren dhe duke shikuar për së afërmi problemet.
Gjate 6 mujorit të parë janë bërë rekomandime për objekte të vjetërsuara dhe që rrezikojnë seriozisht jetën e banoreve dhe kalimtareve.

Gjithashtu, janë shikuar për së afërmi edhe pikat të rrezikut cilat në raste të caktuara mund të paraqesin rrezik për qytetarët.

Përgatitja e fazës së dytë për vendosjen e kamerave në qytetin e DeçanGrumbullimi i të dhënave për aparatet për shuarjen e zjarrit të i posedojnë të gjitha shkollat dhe objektet e institucioneve tjera në komunën e Deçanit.

**Trajnime dhe aktivitete te ndryshme**

Duhet cekur se të gjitha trajnimet e parapara për vitin 2019 për sektorin e Mbrojtjes dhe Shpëtim në gjashtë mujorin e parë (Janar – Qershor )nuk janë zhvilluar (mbajtur) për arsye se në qendrën e trajnimeve në Vushtrri nuk ka pasur mundësi të mbahen për arsye se ka qenë e ngarkesë e tepërt e trajnimeve në qendrën e lartë cekur.

**<u>Të përgjithshme</u>**

1. Pjesëmarrje në takimet e KKSB-së ku si temë kryesore ka qenë siguria në komunën e Deçanit.
2. Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe ka realizuar edhe detyrat tjera të përditshme, ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha drejtoritë komunale, me komunat në regjion, Institucionet Qendrore, sidomos me AME, FSK-në, Policinë e Kosovës, KFOR-in, Kryqin e Kuq, dhe OJQ-të.
3. Azhurimi në intranet i kërkesave të qytetarëve dhe organizatave të ndryshme të cilat adresohen në Drejtorinë e MMSHP-së.
4. Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve me NJPZSH-në si dhe përgjigje ndaj të gjitha kërkesave të tyre.
5. Evidentimi i të gjitha rreziqeve të mundshme në tërë territorin e komunës së Deçanit.
6. Bashkëpunimi me zyrtarët e drejtorisë.
7. Përgatitja e masave parandaluese si dhe njoftimi nga aspekti i MNZ-së në pyje dhe sipërfaqe fushore gjatë sezonit të korrje shirjeve.
8. Përgatitja e dokumentacionit (lëndëve të miratuara) gjatë vitit 2018 për arkivim.

## Raporti i punëve të kryera gjatë periudhës 01.01.2019 – 01.06.2019

- Hartimi i raportit të punës për periudhën 01.01.2018 gjer 31.12.2018 i cili është prezantuar Drejtorit të Drejtoratit për Mbr. Shp. dhe Shërb. Pub. dhe dërguar edhe A.M.E -në Prishtinë.
- Hartimi i Planit të punës i detaizuar për periudhën 01.01. 2019 gjer 31.12.2019 për Drejtorit të Drejtoratit për Mbr. Shp. dhe Shërb. Publike dhe dërguar edhe A.M.E në Prishtinë.
- Në fillim të çdo muaji të periudhës së parë dhe të dytë të vitit kalendarik, janë hartuar Planet e punës për vitin kalendarik dhe çdo her herë me shkrim është njoftuar edhe Drejtori i Drejtoratit për Mbr. Shp dhe Shërb. Publike dhe AME- Departamenti i parandalimit Prishtinë
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën e tre mujore të vitit 2018
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën gjashtë mujore të vitit 2018 **gjithsejtë** = 5 shkresa

**Njoftime për menaxherë te objekteve , në të cilat janë kryer inspektimet e rregullta , se për të njëjtat ka përfunduar procedura ligjore për masat e mbrojtëse nga mbrojta e zjarrit të Urdhëruara me Vendim .**

- **Me këto shkresa janë Njoftuar** gjithsejtë =0

1. **INSPEKTIMET :**
   - **Inspektime fillestare :** gjithsejtë ....0
   - **Inspektime të rregullta :** gjithsejtë......... 0
   - **Inspektime verifikues :** gjithsejtë........... 0
   - **Inspektime i jashtëzakonshëm:** gjithsejtë...... 3
   - **Inspektime fillestare, jashtëzakonshme, verifikuese** ......**gjithsejtë** = 3
   - **Deklarime** gjithsejtë = 0
   - **Akte përcjellëse** gjithsejtë = 0

2. **VENDIMET MBI MASAT E URDHËRUARA**
   - Hartimi i Vendimeve mbi masat e urdhëruar nga mbrojtja e zjarrit **gjithsejtë** = 0

3. **VENDIMET PËR NDËRPRERJEN E PËRKOSHME TË PUNIMEVE NË OBJEKTE:**
   - Vendime mbi ndërprerjen e përkohshme të punimeve **gjithsejtë =** 0

4. **DALJA NË TEREN PËR SHIKIMIN E VENDIT KU PARASHIHET TË NDËRTOHEN OBJEKTET E NDRYSHME:**
   - Dalja në teren **gjithsejtë =** 0

5. **HARTIMI I PROCESVERBALIT PËR SHIKIMIN NË DOKUM. INVESTIVO TEKNIK PËR OBJEKTE TË NDRYSHME:**
   - Procesverbale të tilla janë **gjithsejtë =** 0

6. **DHËNJEN E PËLQIMEVE NË DOKUMENTACIONIN INVESTIVO TEKNIK PËR OBJEKTE TË NDRYSHME.**
   - Pëlqimet e të tilla janë **gjithsejtë** = 0
7. **DHËNIA E PËLQIMEVE NË RREGULLOREN E BRENDSHME nga MNZ PËR OBJEKTET E NDRYSHME:**
   - Pëlqime të tilla janë **gjithsejtë** = 0



8. **DHËNIA E PËLQIMEVE NË PLANIN E MBROJTJES NGA ZJARRI :**
   - Pëlqime të tilla nuk kemi pasur gjatë kësaj periudhe. **gjithsejtë = 0**

9. **AUTORIZIMET:**
   - Hartimi i autorizimeve të lëshuara nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri konform Ligjit për mbrojtje nga zjarri 04/L-012- 2011 **gjithsejtë** = 1

10. **KONSTATIMI DHE VERIFIKIMI I ZJARREVE:**
    - Konstatimi, verifikimi dhe hulumtimi i shkaqeve të zjarrit dhe dalja në vendin e ngjarjes me rastin e shpërthimit të zjarrit gjatë periudhës 6 mujore **gjithsejtë = 117** zjarre.

**11. VËRTETIME:**

- Në bazë të kërkesa të parashtruara nga palët lidhur me lëshimin e dëshmisë se ka pasur zjarr në palujtshmërit e tyre: **gjithsejtë** = 2

**12. HARTIMI I KËRKESAVE PËR PLOTËSIM LËNDE:**

- Përpilimi dhe dërgimi i kërkesës për plotësim lënde **gjithsejtë** = 1

**13. HARTIMI I RAPOPRTEVE PËR ZJARRET E NDODHURA DHE KERKESAVE TJERA DËRGUAR POLICISË SË KOSOVES Stacioni POLICOR NË DEÇAN**

- **Gjithsejte = 3**

**14. SHKRESA DËRGUAR A.M.E-ës NË PRISHTINË:**

- Shkresa të tilla dërguar A.M.E-ës **gjithsejtë** = 0

**15. HARTIMI I SHKRESAVE PËR DREJTORATIN PËR MBR.SHP. DHE SHËRB. PUBLIKE :**

- Sipas kërkesës së kësaj kemi hartuar **gjithsejtë** = 3 shkresa.

**16. REFUZIMI I KËRKESAVE :**

- Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur lëndë të cilat është dashtë të refuzohet kërkesa .

**17. HARTIMI I KËKESAVE PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KUNDËRVATJE:**

- Hartimi i kërkesave për fillimin e procedurës për kundërvajtje: **gjithsejtë** = 0

**18. MBROJTJA E LËNDEVE ME RASTIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS PËR KUNDËRVATJE NË GJYKATËN KOMPETENTE:**

- Mbrojtja e lëndëve me rastin e fillimit e procedurës për kundërvajtje në Gjykatën kompetente **gjithsejtë** = 0

Në librin e protokollit të shkurtër janë evidentuar 5 shkresa si: Akte përcjellëse, Autorizime, Ftesa për palët, Njoftime për përfundimin e procedurës ligjore, Konkluzionet , kërkesa për plotësim lënde e tjera, të cilat punë kanë qenë të pa planifikuara mirëpo janë të domosdoshme gjatë zhvillimit të procedurës ligjore.

Takime pune dhe konsultime e Drejtoratin për Mbr. Shp. dhe Shërb. Publike KK- Deçan dhe takime tjera me A.M.E – në – Departamenti i parandalimit ndaj zjarrit në Prishtinë.

Takime punë me zyrat e parandalimit ndaj zjarrit me Komunat fqinjë. Takime zyrtare me përfaqësuesin juridik të objekteve me rëndësi të veçantë nga mbrojtja e zjarrit.

Kryerja e disa punëve të përditshme administrative: si përgatitja e fletë dorëzimeve, dërgimi i shkresave palëve në procedurë nëpërmjet shërbimit të postës dhe direkt në dorë, përgatitja e thirrjeve për palët në procedurë, konsultime me palët , evidentimi në regjistrat e inspektimeve e tjera.

**Sektori për Shërbime Publike**

Bazuar në planin vjetor të punës të planifikuara për vitin 2019, Sektori për Shërbime Publike në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 ka kryer këto punë dhe detyra :

**Aktivitete të planifikuara dhe të bazuara në planin vjetor të punës për vitin 2019**

- Organizimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e punëve në fushën e shërbimeve publike, duke i zbatuar ligjet dhe rregulloret në fuqi për ofrimin e shërbimeve sa më të mira publike për qytetarët e komunës sonë.

- Përcjellja e vazhdueshme e punimeve të SH.A. "Higjiena" që është e kontraktuar për mbledhjen, grumbullimin dhe heqjen e mbeturinave në hapësirat publike komunale.

-Mbikëqyrja e mirëmbajtjes verore / dimërore të rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe fshatra, planifikimi, përcjellja dhe menaxhimi i kontratave për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve.

-Mirëmbajtja e kanalizimit i ujërave të zeza dhe ujerave atmosferike si dhe vendosja e kapakëve të pusetave, ndërrimin e gypave pastrimin e pusetave të ujërave atmosferike.

-Menaxhimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik.

-Menaxhimi i kontratës për stolisjen e qytetit të Deçanit gjatë festave të ndryshme.

**Projekte të realizuara gjatë vitit 2019**

- Në Mars të vitit 2018 , Kryetari i Komunës z.Bashkim Ramosaj së bashku me GIZ-in gjerman nënshkruan memorandum për menaxhimin e mbeturinave për komunën e Deçanit. Fillimisht është krijuar grupi punues të cilët kanë bërë mbledhjen e të dhënave në teren , regjistrimin e ekonomive familjare dhe bizneseve, si dhe punimin e planit të punës dhe planit operativ, plan i cili është duke vazhduar.
- Vazhdimi i planit për Menaxhimin e Mbeturinave, kanë përfunduar procedurat e prokurimi për furnizim me dy kamionë për SH.A. "Higjiena", si dhe është në procedurë të prokurimit edhe ndërtimi i objektit të kompanisë.
- Në kuadër të këtij plani është bërë identifikimi i të gjitha deponive ilegale që janë në territorin e komunës së Deçanit, si është hartuar projekti për eliminimin e këtyre deponive dhe është duke u zbatuar. Janë eliminuar deponitë më të mëdha siç janë: deponia te ura në mes fshatrave Prapaqan- Llukë e Ulët, te ura Llukë e Epërme – Isniq dhe deponia në oborrin e Hidro – Drini, të cilat janë rrethuar si dhe bërë mbjellja e barit dhe janë shndërruar në hapësira gjelbëruese.
- Mirëmbajtja e hapësirave publike të gjelbëruara (parqeve , shesheve) në qytet dhe në fshatra.

- Bashkëpunim pune me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare si me USAJD-in, OSBE-në, Giz-in, me Ministrinë e Transportit, Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinore, me ndërmarrjet publike komunale dhe regjionale, me inspektorët nga Ministria e Punëve të Brendshme, inspektoret e rajonit etj.;

- Që nga Janari e deri në Qershor 2019 janë asfaltuar mbi 7.17 km rrugë në territorin e komunës sonë.

Gjatë periudhës nga 01.01.2019 deri me 01.06.2019 nga Zyrtari për transportin lokal dhe rrugë lokale, ka kryer këto punë dhe detyra:

- Hartimi i planit vjetor të punës për vitin-2019,
- Hartimi i planit mujorë të punës për vitin-2019,
- Bashkëpunimi me subjektet me rëndësi të veçantë (Policin e Kosovës, Inspektorin e Ministrisë, përfaqësues të komuniteteve) etj,
- Bashkëpunimi me M.T.P.T.K dhe zyrës ndër komunalë,
- Koordinimi mbi aktivitetin e transportit publik të mallrave dhe udhëtarëve me kompanitë publike dhe taksitë individualë,
- Caktimi i linjave për bartjen e udhëtarëve në trafikun urban,
- Dhënia e pëlqimit për regjistrimin e taksistëve sipas rregullores së komunikacionit (16 leje),
- Bashkëpunimi me Policinë e trafikut për lirimin e trotuareve nga automjetet,
- Caktimi i drejtimeve rrugore për qarkullimin e automjeteve në zonën urbane dhe lokacionet e limituara për parkingje,
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i kontratës për sinjalizimin(shënjimin) vertikal dhe horizontal të rrugëve lokale,
- Propozimi për mbylljen e përkohshme të rrugëve në rast nevoje si festa, protesta etj. (2 herë),
- Kujdesia për renovimin e rrugëve lokale si atyre të asfaltuara ashtu edhe të atyre të pa asfaltuara ,
- Njoftimi sipas nevoje M.T.P.T.K. për riparimin e shenjave, defekteve në rrugët ndër komunale,
- Përkujdesja për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe shesheve në sezonin dimëror.
- Lëshimi i lejeve për vendosjen e pengesave në rrugët që janë në kompetencë të komunës.(2 lëshime të lejeve)
- Kryerja e punëve të tjera sipas ligjit dhe rregullores në fuqi dhe përgjigjja e kërkesave të drejtorit dhe departamentit.
- Tërheqje vërejtje dhe pesë (5) procesverbale gjatë kontrollit të transportit publik.
- Menaxhimi i kontratës për servisimin e automjeteve zyrtare.
- Menaxhimi i kontratës për shpenzime të derivateve të naftës.
- Lëshimi i vendimeve për parkimin e automjeteve pranë lokaleve afariste në kohëzgjatje prej 30 minutave me qëllim të shkarkimi dhe ngarkimit të mallit.
  Lëshimi i lejes për prerjen e asfaltit me qëllim të vendosjes të kabllove elektrike.

Përfundimi i rrugës "Kilaj' me gjatësi prej 1400 m plani dinamik për dy vite i realizuar në periudhën kohore prej një viti;

- Rruga për fshatin turistik "Belle" segmenti gjatësor prej 1400 m është në fazën përfundimtare të rregullimit për asfaltim, ndërsa pjesa tjetër duhet të fillohet me muret mbrojtëse;
- "LOT - 2", punë kryerësi "Arfa Group" Sh.p.k deri me tani ka realizuar 20570 m rrugë duke përfshirë edhe kanalet për ujitje në gjatësi prej 240 m prej 20570 m të hapura janë asfaltuar deri me tani 1300 m pjesa tjetër është në përgatitje e sipër;
- Në kuadër të mirëmbajtjes verore me kompaninë Lika Trade kemi realizuar punime prej të cilave vetë asfaltim kemi 3.2 km kurse shërbimet tjera janë largim i dheut, furnizim me zhavorr etj.;
- Në kuadër të Efiçiencës kemi përfunduar Planin për Energji të Efiçiencës përkatësisht draft planin i cili është miratuar në asamblenë komunale si dhe jemi në përfundim të të dhënave për objektin e komunës për tenderim në kuadër të Agjensionit për EEF – Hartimin e projekteve për eliminimin e deponive ilegale;
- Bashkëpunim pune me organizata ndërkombëtare si me USAID –in, GIZ-in, ASA-në, etj, si dhe trajnime për Efiçiencën e Energjisë;
- Raportimi i vazhdueshëm për përmirësimin e energjisë efiçiente ;
- Fillimi i punimeve në rrugën e qendrës hapja e trasesë në gjatësi prej 500 m, punime të cilat do të vazhdojnë deri te qendra e qytetit.

## 5. *Drejtoria për Buxhet dhe financa Zyra e Tatimit në Pronë*
***Gjatë përjudhës Janar-Qërshor 2019***

**Për:** Drejtoria për Buxhet dhe Financa
**Nga:** Anketuesit, Zyra e Tatimit në Pronë
**DATË:** Nga-01/ 03 / 2019 – 16/ 07/ 2019
**Lënda:** Regjistrimet e Reja dhe Verifikimet e objekteve në teren

# RAPORT TOTAL

| VENDI | NR. VERIFIKIMEVE | NR. REGJISTRIMEVE | TOTALI |
|---|---|---|---|
| DUBOVIK | 138 | 83 | 221 |
| LLOQAN | 98 | 29 | 127 |
| HULAJ | 20 | 14 | 34 |
| PRAPAQAN | 106 | 32 | 138 |
| PAPIQ | 24 | 09 | 33 |
| POBERGJË | 130 | 24 | 154 |
| ISNIQ | 546 | 169 | 715 |
| STRELLC I EPËRM | 60 | 09 | 69 |
| STRELLC I POSHTEM | 34 | 08 | 42 |
| **TOTALI:** | **1156** | **377** | **1533** |

**ANKETUESIT:**

## 6. *Drejtoria për Bujqësi , Pylltari , dhe Zhvillim Rural*
***Gjatë përjudhës Janar-Qërshor 2019***

REALIZIMI I PLANIT 6 MUJOR P Ë R V I T I N 2 0 19

1.Trajnime me fermer
2. Vizita studimore jashtë Kosove - Slloveni
3. Tri takime me Caritasin CH dhe 1 trajnim
4. Shpërndarja e pajisjeve për 14 bletarë
5. Furnizimi me fidanë dhe materiale tjera për 3 fermer te boronicës dhe 1 te dredhëzës
6. Vizita ne teren , ne ferma
7. Ndihmë për fermer ne grande dhe forma tjera
8. Mbushja e rreth 610 aplikacioneve për subvencione te fermerët tanë
12 ndihmë për aplikime në grande

***7. <u>RAPORT TEKNIKO- FINANCIAR PËR GJYSMËVJETORIM E PARË TË VITIT 2019 Drejtor i Urbanizmit- Janar-Qërshor 2019</u>***

Projektet që menaxhohen nga zyrtarët e drejtorisë së Urbanizmit:

1.**Emërtimi i projektit: Rregullimi i shtratit të Lumit Lumbardh në Deçan (** projekt ne vazhdim**)**

**Kontraktuar : ........................................... 18.10.2018**
**Vlera e Kontratës : ................................ 2,989,329.33 €**
**Në vitin 2018 janë paguar: ................... 300,000.00 €**
**Për vitin 2019 është ndarë buxhet....... 400,000.00 €**
**Janë kryer 15% të punimeve**

2. **Emërtimi i projektit: Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Deçanit (** projekt ne vazhdim**)**

**Kontraktuar :........................................... 19.12.2018**
**Vlera e Kontratës : ................................. 120,000.00 €**
**Në vitin 2018 janë paguar: ...................... 59,999.00 €**
**Për vitin 2019 është ndarë buxhet .... 60,000.00 €**
**Janë kryer 50% të punimeve**

**3.Emertimi i projektit “Kanalizimi i ujerave te zeza ne zonen urbane” (** projekt ne vazhdim**)**

**Investitor: Komuna me bashkefinancim me nivelin qendror**
**Kontraktuar :................................................ 16-07-2018**

**Afati i kontratës : ..........................................36 muaj**
**Vlera e Kontratës : ................................ 238,885.05 €**
**Në vitin 2018 janë paguar: ...................... 114,000.00 €**
**Për vitin 2019 është ndarë buxhet .... 81,500.00 €**
**Janë kryer 50% të punimeve**

**4.Emertimi i projektit "Zgjerimi dhe rikonstruimi i rruges Prilep-Irzniq" (** projekt ne vazhdim**)**

**Investitor: Komuna me bashkefinancim me nivelin qendror**

**Kontraktuar :.......................................... 27-06-2019**

**Afati i kontrates : ..........................................24 muaj**
**Vlera e Kontratës : ................................ 422,002.30 €**
**Punimet nuk kane filluar, parashihet te fillojne ne muajin Korrik 2019**

**5.Emertimi i projektit "Asfaltimi i rrugeve ne Decan, Drenoc, "Arif Demhasaj: ne Strellc te Ulet, Ramosaj dhe Demhasaj ne Carrabreg te Poshtem, Dubovik dhe "Agron Hulaj" ne Prelep." (** projekt ne vazhdim**)**

**Kontraktuar :.......................................... 12-06-2018**

**Afati i kontrates : ..........................................24 muaj**
**Vlera e Kontratës : ................................ 3,179,117.43 €**
**Në vitin 2018 janë paguar: ...................... 792,909.73 €**
**Në vitin 2019 janë paguar: ...................... 348,794.87 €**
**Në Korrik 2019 janë faturuar: ...................... 232,501.24 €**
**Janë kryer rreth 50% të punimeve**

**6. Emertimi i projektit "Ndertimi i memorialeve ne fshatin Lumbardh, Lloqan, Glloxhan dhe Beleg" (** projekt ne vazhdim**)**

**Kontraktuar :.......................................... 29-08-2018**

**Afati i kontrates : ..........................................24 muaj**
**Vlera e Kontratës : ................................ 98,772.86 €**
**Në vitin 2018 janë paguar: ...................... 46,185.62 €**

**Në vitin 2019 janë paguar: ...................... 19,198.88 €**

**Janë kryer rreth 75% të punimeve**

**7. Emertimi i projektit "Asfaltimi i rruges ne fshatin Sllup"** ( projekt ne vazhdim)

**Kontraktuar :...................................... 01-06-2018**

**Afati i kontrates : ..........................................36 muaj**

**Vlera e Kontratës : .................................. 339,222.78 €**

**Në vitin 2018 janë paguar: ...................... 148,771.00 €**

**Në vitin 2019 janë paguar: ...................... 27,553.60 €**

**Për vitin 2019 eshte ndare buxheti:...... 162,898.18 €**

**Janë kryer rreth 52% të punimeve**

**8.Emërtimi i projektit" Ndertimi i biblotekes ne fshatin Carrabreg i Eperm, Decan**

**Investitor: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

**Kontraktuar :........................................... 03.06.2019**

**Vlera e Kontratës : ................................. 13,000.00 €**

**Punëkryes:....................................... "Albi Company" Rahovec**

**Punimet nuk kanë filluar, parashihet të fillojnë në muajin Korrik 2019**

**9.Emërtimi i projektit: Rikonstruimi i rrugëve të bjeshkëve në Deçan** ( projekt ne vazhdim- 3-vjeqarë.)

**Kontraktuar : ........................................... 15.05.2019**

**Vlera e Kontratës : ................................ 266,180.00 €**

**Për vitin 2019 është ndarë buxhet....... 100,000.00 €**

**Janë kryer 25% të punimeve**

**10.Emërtimi i projektit: Renovimi i objektit të banimit kolektiv pas Qendrës për punë sociale** ( projekt ne vazhdim)

**Kontraktuar :........................................... 21.11.2018**

**Vlera e Kontratës : ................................. 77,727.00 €**

**Në vitin 2018 janë paguar: ...................... 77,727.00 €**

**Për vitin 2019 kanë mbetur vetëm aneks kontrata .... 7,146.00 €**

**Janë kryer 98% të punimeve**

11.**Emertimi i projektit "Ndërtimi i Aneksit të Urgjencës dhe Renovimi i QKMF në Deçan"** **(** projekt ne vazhdim-3vjeqarë**)**

**Investitor: Ministria e shëndëtsisë**

**Mbikqyrja: K.K. Deçan**

**Kontraktuar :.......................................... 03.09.2018**

**Afati i kontratës : .......................................36 muaj**
**Vlera e Kontratës : ................................. 294,989.17 €**
**Në vitin 2018 janë paguar: ...................... 40,000.00 €**
**Për vitin 2019 është ndarë buxhet .... 150,000.00 €**
**Janë kryer 50% të punimeve**

**Gjate gjysmevjetorit te pare 2019 jane dhene:**

**Leje Ndertimore ..................... 3**

**Leje Mjedisore ....................... 2**

**Kushte Lokacioni.................... 5**

**Ne proces per marrjen e Lejes Ndertimore jane 4 lende.**

**Taksa per leje Ndertimore ............. 11,958.05 €**

**Taksa per Leje Mjedisore ................ 2,055.40 €**

**Taksa per Kushte Ndertimore ......... 60.00 €**

---

**Taksa te mbledhura ne total ........... 14,073.45 €**

***8.<u>Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër</u>***
***<u>Janar-Qërshor 2019</u>***

1. Shefi i Sherbimit njekohesisht edhe zyrtari per RDPP se bashku me referenten e ndryshimeve kadastrale Gjate periudhes per te cilen po raportojme perkatesisht Janar - Korrik te vitit 2019 e deli me daten e perpilimit te kettj raporti , Zyrtari per RDPP ka pranuar gjithsejte 232 kerkesa nga pale te ndryshme per realizimin e to drejtave ligjore qe dalin nga Regjistrimi i te Drejtave ne Pronen e Paluajtshme (RDPP). Nga to gjitha keto kerkcsa deri me tarsi Jane shqyrtuar 220 dhe

per te njejtat .jane leshuar aktvendime adekuate me te cilat paleve iu eshte njohte e drejta ligjore e kerkuar ose ju ka refuzuar e njejta kerkese dhe ju ka dhene e drejta e ankeses ne organin e shkalles se dyte. Ndersa edhe 3 kerkesa jane ne procedure c siper. Aktvendimet me te cilat pales i eshte njohte e drejta ne RDPP, ne afat ligjor dergohen te referentja per ndryshime kadastrale c cila konform ketyre vendimeve bene azhurimin ne librat perkates te elaboratit kadastral dhe te njejta prape i azhurno duke i fut te dhenat ne kompjuter perkatesisht ne programin e SIKTK-cs Krahas ketyre puneve Zyrtari per RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit te sherbimit ka kryer edhe pune tjera nga lemi i sherbimeve pronesoro juridike dhe se bashku me Referenten per ndryshime kadastrale kane kryer edhe pune tjera me urdher te drejtorit .

**2.** Zyrtaret e mirembajtjes se Kadastrit Ne kete sektor punojne tre zyrtar per mirembajtjen e Kadastrit Keta zyrtar gjate periudhes raportuese i kane pasur 102 azhurime te lendeve nga tereni sipas kerkese se paleve prej te cilave te gjitha jane zgjedhur me perjashtim te 2 rasteve te cilat ende jane ne procedure e siper Gjithashtu keta zyrtar gjate kesaj periudhe kane leshuar 9 historiate sipas kerkesave te paleve dhe kane leshuar 190 kopje plani. Gjate kesaj periudhc raportuese keta zyrtar kane dal ne teren per 15 raste nga domeni pronesoro juridik e sipas kerkeses zyrtare te bore nga ana e Komunes se Decanit, per nevoja te Komunes dhe kane here 10 verifikime te Banesave. Si dhe kane kryer edhc detyra tjera sipas nevojave te cilat paragiten ne kete sherbim sib jane konsultat me pale dhe pune tjera ne zyre.

3. Referenti per pranimin e paleve Gjate periudhes per te cilen raportojme, referenti per pranimin e paleve ka pranuar gjithsejte 1613 kerkesa te cilat kryesisht kane te bejne me dhenien c certifikatave to prones se paluajtshme, kopjeve te planit dhe vertetimeve me te cilat vertetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri te paluajtshme, ne territorin e Komunes. I njejti zyrtar i ka proceduar te gjitha keto kerkesa dhe per seeilen kerkese palet jane pajisur me dokumente perkatese ne afatin brenda dites se paraqitjes se kerkeses. Ky eshte raporti i puneve te kryera per periudhen gjashtemujore Janar — Korrik 2019 Raportin e perpiloi : Shefi i kesaj Drejtorie Hasan HuAat Drejto

## *9.**<u>Drejtoria e Shëndetësis ,Punës dhe Mirëqenies Sociale</u>***

***<u>Janar-Qërshor 2019</u>***

Gjatë periudhës janar – qershor 2019,  Drejtoria e Shëndetësisë ka pranuar 80 lëndë për t’u shqyrtuar nga komisioni profesional. Stafi në këtë drejtori, ka pasur takime të përditshme me qytetarë, për t’u  njoftuar me procedura dhe shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

1. **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

Aktivitetet për muajit raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë e shëndetësisë:

- Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj,
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planit të prokurimit 2019;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë;
- Shqyrtimi i mjeteve të ankimit përmes rrugëve administrative;
- Mbarëvajtja e konkursit publik mbi personelin shëndetësor.

## 2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria , duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë shëndetësisë:

- Zhvillimi dhe monitorimi i kontratës:
  - “Renovimet dhe ndertimi në përmirësimin të infrastrukturës së objekteve shëndetësore”:

    - Renovim i hapësiravse së zyres së pranimit:
    - Largim i materialit jo funksional në QKMF ,QMF 3, në mbikëqyrje nga komisioni i caktuar nga QKMF;
    - Fillim i renovimit të hapësirës së sportelit në QkMF ;
    - Takime dhe njoftime të vazhdueshme të ekipit menaxhues;
  - Furnizim me pajisje mjekësore
  - Furnizim me material administrativ shëndetësor.
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF,
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
- Identifikimi i nevojave rreth specifikave për procedurë të tenderimit:

  - Servisimi dhe mirëmbatja e aparaturës mjekësore në QKMF;
  - Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF-në
  - Furnizim me pajisjeve mjekësore;
- Përpilimi i raporteve: Raport vjetor 2018, si dhe Plani i veprimit i DSH-së në vitin 2019;
- Përgatitja finale – konkursi ideor “Ndërtimi i objektit te ermergjencës;

- Përgatitjet teknike rreth realizimit të aktiviteteve:
    - Vizitat sistematike në shkollat fillore dhe SHMU në komunën e Deçanit;
    - Deratizimi i rrjetit të kanalizimit dhe
    - Dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shëndetësore;
- Fillimi i vizitave sistematike të nxënësve të klasave I, V dhe IX, më 04.03.2019;
- Përgatitja e raporteve buxhetore, javore dhe mujore, në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- Mbikëqyrja, shfrytëzimi - realizimi i buxhetit përmes programit Free balance;
- Koordinimi i punëve dhe bashkëpunim i QKMF-së me Drejtorinë e Financave dhe Zyrën e prokurimit, për harxhimin e buxhetit në bazë të rrjedhës së parasë;
- Kontrollimi, mbikëqyrja e buxhetit dhe miratimi i tyre sipas fondit, kodit dhe kategorive ekonomike;
- Planifikimi, raportimi dhe mbajtja e evidencës së shpenzimeve të buxhetit (në kategoritë mallra dhe shërbime, dhe Komunali dhe subvencioneve);
- Alokimet;
- Pranimi i faturave;
- Përgatitja e dokumenteve të nevojshme;
- Zotimet;
- Procedurat e mëtutjeshme – Prokurim dhe Drejtori të Financave;
- Raportimi i shpenzimeve të realizuara në drejtori, sipas kërkesave për raportim;
- Raportimi i obligimeve/borxheve më të vjetra se 30 ditë – Drejtori të Financave;
- Përgatitjen e deklaratave të disponushmërisë për inicim të procedurave të prokurimit;
- Përgatitja e raportit final, të kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë, rreth fondit të huamarrjes mbi përmirësimin e qasjes në shërbime cilësore të kujdesit parësor shëndetësor (KPSH) kuadër planit të veprimit, përmirësimin e përformancës 2018.

## 3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria shëndetësisë për muajit raportues:

- Mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës.
    - Monitorimi i kontratave:
        - Furnizim me material administrativ e shëndetësor;
        - Renovime dhe ndërtime;
        - Pastrimi dhe mirëmbajta higjienike e objekteve shëndetësore të kujdesit parësor shëndetësor;
        - Blerja e autoambulancës meprocedura të prokurimit,
        - Blerja e paisjeve për pastrim dhe mirëmbajtje të objektit.
- Përgatitjet për tenderim:

  - Servisimet dhe mirëmbajtja e aparaturave mjekësore në QKMF dhe njësitë e saj,
  - Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF
  - Furnizim me inventar për nevojat e Institucioneve shëndetësore;
  - Mbarëvajtja e vizitave sistematike në shkollat e komunës së Deçanit.

## 4. STATISTIKAT

Statistikat përkatëse për drejtorinë shëndetësisë, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuara, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria e shëndetësisë. Renditja sipas kategorive..

### 4.1.1 *Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese*.

| Fondi burimor | Planifikuara | Alokuara | Shpenzuara | Nr. lëndëve |
|---|---|---|---|---|
| Pagat | 445,372.57 | 445,372.57 | 445,372.57 | |
| Mallra dhe shërbime | 80,898.46 | 80,898.46 | 79,798.46 | |
| 10 | | | | |
| 21 | 31000 | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Huamarrja | 17,175.00 | 17,175.00 | 13,200.00 | |
| Komunali | 45,000.00 | 45,000.00 | | |
| Kapitale | | | | |
| | | | | |

- Të ketegoria e mjeteve te marrura nga huamarrje e terë shuna e planifikuar për vitin 2019 me memorandum të mirkuptimit në mesë të Ministris së Shendetsis, Bankes Botërore dhe Kryetarit të Komunes së Deçanit është bartë te M SH
-Të kategoria e investimeve Kapitale blerja e nji autoambulance janë kryer të gjtha procedurate prokurimit ,dihet OE i cili duhettë na furnizoi , por automjet ende nuk ka ardhur e mu për kete arsye mjetet ende nuke janë berë sghpenzim .

## 5. AKTIVITETE E PËRDITSHME

***Takime të niveluit qendror të ministrive dhe instuticionëve tjera përkatëse***

### *5.1.1 Takimet me palë*

- Çdo dit pune, nga ora 9:00 - 16:00. Drejtoria e Shëndetësisë bën pranimin e palëve.

- ***5.1.3 Takimet me institucione të tjera në nivel Komunal***

- Drejtoria e Shërbimeve Publike:
  - Lehtësimi i qarkullimit të veturave zyrtare me pacientë në mot me borë;
  - Lehtësimi i qarkullimit të autoambulancës në afërsi të objektit ;

- Drejtoria e Investimeve Kapitale:
  - o Menaxhim i kontratës – renovime dhe rindërtime;
- Drejtoria e Prokurimit:
  - o Procedura rreth kontratave të ndryshme;

### *5.1.4 Diskutime publike/takimet me qytetarë*

Gjatë kësaj periudhe ka pasur takime me qytetarë gjatë orarit të punës 8:00 – 16:00, çdo dite pune, përveç takimit të palëve me drejtorin.

### *5.1.5 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare*

### *5.1.6 Lëndët e pranuara, të kryera dhe në përfundim e sipër*

- Të pranuara në DSH ishin 80 lëndë, dhe të gjitha janë përfunduar.

### *5.1.7 Përfitues të subvencioneve:*

Jan subvencionuar nga zyra e kryetarit të komunës përmes drejtorisë së shëndetësë 15 përsona të cilët kanë shtruar kërkesa emergjente.

### *5.1.8 Takimet dhe trajnime të tjera me:*

- Ministrinë e Shëndetësisë;
- Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë;
- AQH.

**6 SFIDAT**

Gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme:

- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë mallra dhe shërbime, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

**7 AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN PASUESE**

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve, bazuar në planin e prokurimit;;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit, për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme.

## Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ( QKMF )

**’’Adem Ukëhaxhaj’’ në Deçan**

1. Veprimtaria e QKMF-së përfshin ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore per popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.
2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithe banorëve të Komunes së Deçanit, t’u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirës dhe efikase, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithe kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe, njëherit pikë referuese per specialistët konsultant në nivelet të tjera të kujdesit shëndetësor.
3. Sipas strategjisë së KPSh dhe standarteve të përcaktuara nga Ministrai a Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermiere familjare ofron shërbime shëndetësore për 2000/2500 banorë sipas shtrirjes teritoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF-së.

**<u>EDUKIMI DHE PROMOVIMI SHËNDETESOR</u>**

Dita botërore kundër TBC-së, në vazhdën e aktiviteteve të KEPSH-së, me qëllim të edukimit dhe promovimit shëndetësor të popullatës, janë mbajtë ligjërata edukative për pacientët e Qendrave Familjare lidhur me këtë sëmundje.

Më 25 mars 2019, me rastin e Ditës Botërore të Tuberkulozit, është organizuar Manifestim qendror në QKMF”, ku morën pjesëtë gjithë profesionistët shëndetësorë, si dhe përfaqësues nga QKMF-ja.
Vizita në komunitet për vetëdijesimin e qytetarëve me sëmundje kronike me diabet dhe hipërtension matja e glikemis ,matja e hipertensionit dhe diagnostifikimie dhe diagnostifikimin e tyre cila filloj në janar dhe përfundon në prill 2019
Vetëdijesimi i të rinjëve për dukuritë negative si :Duhani,Alkooli,sst-HIV-AID-si të cilat janë mbajtun 18 ligjerata në 18 shkolla të mesme të ulta të Komunës së Deçanit për klasët e XIII-IX

***SHTËPIA E REZIDENCIALE E  KOMUNITETIT***

- Shtëpia e Komunitetit ne Deçan ka nevoja të shumta për të funksionuar ashtu siç duhet, por këtë vit kemi planifikuar duke u bazuare edhe ne buxhetin e keti viti ti kryejmë këto punë:
- Deklarojm se përpos pagave dhe meditjeve  të stafit tonë ne i kemi edhe dy  punëtore sigurimi si dhe Neuropsikatrin po ashtu edhe një punëtore teknike të planifikuar për vitin 2019 për sigurin dhe mbarvajtjen e punëve.
- Po për këtë vit kemi planifikur ta zgjerojmë një pjesë për administrates pasi që zyra  është e vendosur ne koridorin e objektit dhe nuk i ploteson kushtet dhe pengon banoret per qarkullim. Duke analizuar se objektit i mungon pjesa administrative kemi menduar se me zgjerim te objektit të bëjmë ngritjen e një gjysem kati mbi pjesën ekonomike sepse objektit i mungon një deponi për ruajtjen e mjetëve teknike të shtëpise.
- Rregullimi i ambientit të jashtëm dhe përshtatja për aktivitete të banoreve gjate stinës së verës.
- Po ne gjashtë ( 6 )  mujorin e parë kemi arritur që jo vetëm  të ralizojmë rregullimin e administratëse  siç e kemi planifikuar por tëresisht objekti ështё shtuar mbi 200 m2 ndertimi i ri dhe renovimi i objektit egzistues, gjithënjë duke ju falenderuar donatorit Homdi Lataj nga Carrabregu i Deçanit,  projekt ky i cili është zgjeruar për pesë ( 5 ) dhoma dhe komplet mbikati i qendrimit ditore dhe pjesës ekonomike egzsistuëse që është planifikuar për administrat.              Po ky donacion na ka ofruar edhe rregullimin e ambientit të jashtëm për rekreacion të pacintëve duke shtuar kushtët dhe komoditetin dhe një jetë sa me të dinjitetshme për këtë kategori të shoqërise. Po ashtu tani po krijohen kushtet që  edhe stafi të ketë mundësi për kualitet ma te mire të punës.

- Po këtë gjashtë ( 6 ) mujorë kemi zotuar 5000 Euro kapitale të cillat do ti shfrytezojmë për rrethojat dhe pastrimin si dhe urbanizimin e pjesës se parkut i cili na mungonte në të kaluaren sepse objekti pasi është zgjeruar edhe më shëumë  është kufizuare ambjenti për levizjën e banorëve.
- Donacioni i sipërpërmenduar na ka mundësuar që buxheti i ndarë për kapitale tani shfrytezohet për rregullimin e parkut për rrethë shtepisë.

- Gjithmonë duke u bazuare në buxhetin që posedojmë e që fillimishtë duhet ti mbuloje ushqimin, barnat dhe hixhenën dhe veshëmbathjen për të kater stinet e vitit, sezonat  këtu tek ne për shkaqe specifike që kanë këta banore duhet të jemi të gatshëm sepse çdo ditë nevoitët të jemi të gatshëm sepse çdo gjë mund të ndodhë e intervenimet duhet të jenë të menjëhershme kur dihet se janë persona me te meta fizike dhe psiqikë dhe dihet dëmtimi i gjerave te shtëpisë.

- Kete gjashtë ( 6 ) mujorë kemi planifikuar dhe zotuar 2250 Euro për eskurzionin në Shqiperi të dhjetë (  10 ) pacientëve dhe pesë( 5 ) persona staf udhëheqes të Shtepisë.

- Pra vitin 2019 ku kodit tone ju kan mar mbi 4.000 euro e qe për shkak të ketyre komplikimeve na kan mbetura pa paguar faturat e vitit 2018 .
- Objektivat tona e Shtepise se Komunitetit në Deçan janë arritur dhe tejkaluare falë punës se palodhshmë dhe lobimit në të mirë të banorve dhe udhëheqsve të Shtepisë ku janë investuar përpos planifikimit buxhetor të ndarë nga Qeveria janë mbi 200.000 Euro investime ne Shtepin e Komunitetit Deçan .

## *10. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport*
***Janar-Qërshor 2019***

Drejtoria për Kulturë ,Rini dhe Sport gjatë përjudhës kohore Janr-Qërshot 2019 ka realizuar këto aktivitete:

**17/02/2019**- "Dita e Pavarësisë"
**24/03/2019**- "Epopeja e Dukagjinit"
**10/03/2019**- "Kupa Gjeravica" – Gara e Skitarisë
**04-05-06/05/2019**- Festivali-"Eshkë e Ndezur mbi Shkëlzen"
**01/06/2019**- "Dita e fëmijëve"

Drejtoria për Kulturë,Rini dhe Sport ka nënshkruar edhe tri Memorandume bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës:

**24/04/2019**- "Ndërtimi i Qendrës Rinore"
**24/04/2019**- "Ndërtimi i Fushës Sportive në Shaptej"
**24/04/2019**- "Ndërtimi i Fushës Sportive në Irzniq"
**24/04/2019**- "Stadiumi i Qytetit në Deçan"

Mmorandum bashkëpunimi me CHËB-në:
**23/05/2019**- "Mbrojtejn ,promovimin dhe konservimin e trashëgimisë kulturore në komunën e Deçanit".

Bibloteka e qytetit të Deçanit:
**10/04/2019**-Bibloteka ka pranuar 294 libra
**12/07/2019-** Bibloteka ka pranuar donacion nga Ministria e Kulturës,135 libra
Në gjashtë mujorin e pare bibloteka ka regjistruar 470 lexues.

Arkivi komunal në Deçan, funksionin e vetë të punës e kryen në harmoni dhe në përputhje me dispozitat ligjore, në harmoni me rregulloret e pushtetit qendror dhe atë të pushtetit lokal.
Punëtoret e këtij sektori kanë bere sistemimin e lendeve te arkivit .

Për periudhën janar korrik të këtij viti, në arkivin komunal të Deçanit kemi kryer punë dhe detyra të caktuara sipas programit të punës, në mënyrë që sa me mirë të bëhet ruajtja e dokumentacionit arkivor.

Nga poseduesit e lendeve kemi kërku qe lendet te sistemohen,të klasifikohen të regjistrohen dhe të përpilohet një listë ku shënohen , lëndët të cilat duhet të arkivohen në depon e arkivit

Nga poseduesit e lëndëve kem kërku, qe lëndët te sistemohen, te klasifikohen, te regjistrohen,dhe te përpilohet një listë ku shënohen , lëndët të cilat duhet te arkivohen në depon e arkivit. Po ashtu dokumentet te cilat duhet te dorëzohen në arkiv, sipas ligjit duhet te jen origjinale e jo kopje.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur pale, të cilat kanë kërkua lëndë të ndryshme për shfrytëzim. Lëndët e kërkuara kanë qenë, raporte të kurorave, aktgjykime, aktvendime te ndryshme numri i te cilave arrin në 90 lëndë **.**

Po ashtu në këtë periudh e kemi berë edhe regjistrimin e 3722 lëndëve, të cilat kanë qenë të vendosura në zyren e arkivit

## 11.***Drejtoria per Inspeksion***

***Janar-Qërshor 2019***

Me qëllim te zbatimit të Ligjit mbi tregtinë e brendshme dhe rregullores Komunale si për identifikimin dhe legalizimin e bizneseve, kemi marrë aksion në Rr. Haki Povataj me anë të cilit kemi inspektuar te gjitha lokalet dhe bizneset te cilat gjenden ne rrugën ne fjalë, si rezultat i kësaj pune janë pajisur me aktvendime dhe leje përkatëse të gjitha ato të cilat nuk kanë disponuar me leje pune.

Inspektime kemi pasur edhe me qëllim për kontrollimin e biznese që merren me prodhimin e bukës ( furrave të bukës ), me çrast kemi marrë masa për ngritjen e kushteve të higjienës së përgjithshme si; dezinfektimin periodik të hapësirave të punës dhe hapësirave te brendshme në përgjithësi, pajisjen me libreza sanitare te stafit, mbajtjen e higjienës se rrobave te punëtoreve dhe mjeteve te punës etj.

Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve, e sidomos pengimin e sëmundjeve apo epidemive të ndryshme që mund të shfaqen ne ambientet e karakterit publik janë bërë inspektime në qerdhen e qytetit, me qellim kontrollin e kushteve te përgjithshme higjienike, mënyrën e ushqimit, mirëmbajtjen e ambienteve dhe mjeteve të brendshme.

Kontrolla të vazhdueshme kemi realizuar edhe nëpër marketet dhe hipermarketet ku tregtohen artikuj ushqimorë në të cilat gravitojnë në masë të madhe qytetarët, me qëllim kontrollimin e artikujve ushqimorë, kushteve të ruajtjes dhe mirëmbajtjes, rregullshmërinë e afateve të skadencës, stabilimentet e ftohjes, higjienës së punëtoreve dhe mjeteve të tyre të punës, mënyrën e furnizimit, et.

Kërkesat nga ana e personave fizik sidomos nga konsumatorët në lidhje me çmimet dhe ndryshimet e tyre kanë qenë evidente dhe në masë të madhe e të cilat janë shqyrtuar me kohë dhe në rastet ku kemi hasur në shkelje eventuale lëndët janë proceduar për gjykatë.

Vlenë të theksohet po ashtu puna e jonë si drejtori në bashkëpunim dhe koordimin me organet policore, policinë e Kosovës, ku kemi marrë aksion për mbylljen e disa lokaleve kryesisht hoteliere te cilat nuk kanë qenë të pajisur me leje përkatëse ( aktvendim ) te lëshuar nga organet kompetente Komunale e të cilat kanë qenë të obliguar ligjërisht ti kenë, e me këtë rast kemi bërë mbylljen e këtyre bizneseve konform dispozitave ligjore.

Po ashtu në lëmine e Tregut e në veçanti për luftimin e bizneseve joformale apo të ndaluara janë kryer kontrolle nëpër bastore dhe lojëra te fatit e te cilat janë mbyllur pas vendimit te Qeverisë se Kosovës për mbylljen e lojërave të fatit.

Ne si drejtori e Inspeksioneve gjatë kësaj periudhe kohore hapsirë të veqantë i kemi kushtuar edhe respektimit të orarit të punës, bazuar në Rregulloren Komunale e cila e precizon në mënyrë të qartë orarin e punës së të gjitha bizneseve, po ashtu duke marrë parasyshë natyrën e punës së tyre. Me qëllim rrespektimi të kësaj rregullorje kemi marrë aksione edhe pas orarit zyrtarë të punës tonë dhe në rastet kur kemi hasë në shkelje nga ana e lokaleve të ndryhsme afariste ndaj tyre janë marrë masa konform ligjeve dhe rregullores Komunale, andaj rastet e tilla janë proceduar për në gjykatë.

1..Kontrolla inspektuese në terren sipas detyrës zyrtare-92
2. Kontrolla inspektuese në terren sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik-30
3. Procesverbale të hartuara për konstatimin e gjendjes-71
4. Aktvendime-22
5. Kërkesa për gjykatat kompetente-9
6. Të tjera ( specifiko )- 32
Ps:Raporti nga Inspektoia e Ambientit mungon mbase ajo gjendet në pushim vjetor.

**Deçan 23 Korrik 2019**